

UDHËZIM
Nr. 3078, datë 18.4.2016

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TAVAN QË DO TË PËRDORIN PERSONAT
JURIDIKË DHE FIZIKË TË AUTORIZUAR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E METROLOGJISË,
SI DHE LABORATORËT E ETALONËVE KOMBËTARË, JASHTË DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, "Për metrologjinë", i ndryshuar, neni 63, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ministri i Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZON:

1. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe laboratorët e etalonëve kombëtarë, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përdorin tarifa jo më të larta se sa tavanet përkatëse për shërbimet metrologjike, të përcaktuara në tabelat nr. 1, tabela nr. 2 dhe tabela nr. 3, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi.

2. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për kryerjen e shërbimeve metrologjike, të përdorin si tarifa tavan gjatë kryerjes së shërbimeve metrologjike të përcaktuara në autorizim, tarifa të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët e etalonëve kombëtarë jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për monitorimin e tyre.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi**

Tabela 1

TARIFAT TAVAN PËR VERIFIKIMIN PERIODIK TË MATËSVE TË UJIT NË PRURJEN NOMINALE Q_n

- Deri në 5 m³/h650 lekë/copë;
- Mbi 5 m³/h deri në 50 m³/h 900 lekë/copë;
- Mbi 50 m³/h deri në 100 m³/h1 050 lekë/copë;
- Mbi 100 m³/h deri në 200 m³/h2 050 lekë/copë;
- Mbi 200 m³/h deri në 500 m³/h5 150 lekë/copë;
- Mbi 500 m³/h10 300 lekë/copë.

Tabela 2

**TARIFAT TAVAN TË SHËRBIMIT PËR VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË CISTERNAVE RRUGORE
(AUTOBOTEVE)**

Nr.	Emërtesa	Tarifa (në lekë)
1	Deri në 5000 dm ³	7000
2	Mbi 5000 dm ³ deri 10000 dm ³	8000
3	Mbi 10000 dm ³ deri 15000 dm ³	9200
4	Mbi 15000 dm ³ deri 20000 dm ³	10000
5	Mbi 20000 dm ³ deri 25000 dm ³	11000
6	Mbi 25000 dm ³ deri 30000 dm ³	12000
7	Mbi 30000 dm ³	13000

Për verifikimin e autoboteve (cisterna rrugore) me shumë ndarje, të ndara nga njëra-tjetra, kur verifikimi i ndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës së kapacitetit të autobotit, i shtohet pagesa prej 50% të verifikimit të vëllimit përkatës të çdo ndarje.

Tabela 3**TARIFAT TAVAN TË SHËRBIMIT PËR VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË VAGONCISTERNAVE**

Nr.	Emërtesa	Tarifa (në lekë)
1	Vagoncisterna deri 25000 dm ³	16000
2	Vagoncisterna mbi 25000 dm ³	20000

Shënim. Tarifat tavan në tabelat e mësipërme janë në vlerë totale, përfshirë TVSH-në.